

8 Pasi bën shënimin, palose fletën e votimit në mënyrë që të paktën një nga vulat në pjesën e pasme të fletës të jetë e dukshme.

9 Hidhe fletën e palosur të votimit në kuti dhe largohu nga QV.

Në rast se nuk pranon të kryesh identifikimin elektronik apo të vendosësh shenjën me bojë në gisht, NUK MUND TË VOTOSH!



KUJDES!


Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë
Ti voton vetëm për vete dhe vetëm një herë. Votimi për personat e tjerë, votimi familjar apo votimi më shumë se një herë ndëshkohet nga Kodi Penal.

DITËN E VOTIMIT MOS HARRO TË:


Mbash maskë

Dezinfektosh duart

Ruash distancën 1,5m



OSCE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Fletëpalosje e prodhuar nga projekti "Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar në Shqipëri"
Mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



VOTA JOTE, ZËRI YT!

VOTO PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË 25 PRILLIT 2021!

Zgjidh, Voto, Vendos!



PROCEDURAT E VOTIMIT

Qendra e Votimit (QV) hapet në orën 07:00 dhe mbyllet në orën 19:00

1 Pasi hyn në QV, drejtohu tek Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV), thuaj emrin dhe paraqit dokumentin e identifikimit.

2 KQV verifikon dokumentin e identifikimit në pajisjen elektronike. Në ekran shfaqen emri, mbiemri, numri personal, fotografia dhe numri yt rendor në listën e zgjedhësve.

3 Ti identifikohesh në mënyrë elektronike duke skanuar gjurmën e gishtit të madh të dorës së djathtë në pajisje. Kur leximi i dokumentit dhe skanimi i gjurmës së gishtit kryhen me sukses, në ekran del një dritë jeshile.

4 Një anëtar i KQV-së të vendos shenjë dalluese me bojë të posaçme në gishtin e madh të dorës së majtë.

5 KQV të jep një fletë votimi, pasi ke kryer identifikimin elektronik. Fleta e votimit duhet të ketë në pjesën e pasme dy vula: të KQV-së dhe të kryetarit të KQV-së.

6 Pasi merr fletën e votimit, hyr i/e vetëm/me në dhomën e fshehtë.

7 Shëno tek kutia e subjektit zgjedhor dhe/ose vetëm një nga kutitë që ka numrin e kandidatit të preferuar shenjën "x" ose "+". Shenja duhet të vendoset brenda kuadratit.

PSE DUHET TË VOTOSH?

- Votimi është një e drejtë që garantohet me ligj. Ushtroje këtë të drejtë!
- Votimi është një detyrim moral karshi shoqërisë. Përmbushe me përgjegjshmëri!
- Zgjedhjet përcaktojnë se kush do të marrë vendime në emrin tënd për 4 vitet e ardhshme!

KUSH VOTON?

Të drejtën për të votuar e ka çdo shtetas shqiptar që ka mbushur 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike apo gjendjeje ekonomike.

KUJTESË!

Kontrollo emrin në listën e zgjedhësve të afishuar në qendrën tënde të votimit ose online në faqen e KQZ-së apo duke shkarkuar aplikacionin "KQZ" në telefon. Nëse emri yt nuk gjendet në listën e zgjedhësve apo emri është i pasaktë, ke të drejtë të paraqesësh kërkesë në gjykatën e shkallës së parë brenda datës 23 prill 2021.

Në ditën e votimit duhet të kesh me vete një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- Kartën e identitetit ose
- Pasaportën